



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.852/5 prot.

Datë 06.06.2023

**V E N D I M**  
**Nr. 474/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.06.2023 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Lurimi” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-60602-02-27-2023, me objekt: “*Hartimi i Planit të Mbarështimit të Pyjeve e Kullotave (PMPK), Bashkia Kolonjë (EKONOMIA PYJORE Qëndër Novosele),viti 2023*”, me fond limit 6,158,250.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 13.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kolonjë

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik BOE “*ETTA CONS SHPK & ARABEL – STUDIO SHPK & JOKLEN & CO SHPK*” në procedurën e mësipërme të prokurimit.

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Kolonjë  
*Sheshi “ Rilindja ”, Kolonjë*

**Ankimues:** “LURIMI” SHPK  
*Lagjia “Drita” Burrel, Mat*

**Subjekt i interesuar:** BOE “*ETTA CONS SHPK & ARABEL – STUDIO SHPK & JOKLEN & CO SHPK*”

*Njësia 14, Rruga "Milto Sotir Gura", zona kadastrale 3866, Nr. Pasurie 306/370-1-5, Tiranë*

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:**

**I**

*Vlerësimi paraprak*

I 1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

I.4. Ankimuesi nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II**

*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 28.02.2023, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-60602-02-27-2023, me objekt: “Hartimi i Planit

të Mbarështimit të Pyjeve e Kullotave (PMPK), Bashkia Kolonjë (EKONOMIA PYJORE Qëndër Novosele),viti 2023”, me fond limit 6,158,250.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 13.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kolonjë.

II.2. Në datë 13.03.2023 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Referuar sistemit të prokurimit elektronik, rezulton se në datën 25.03.2023, është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat pa TVSH si më poshtë:

- |   |                |              |
|---|----------------|--------------|
| 1. “LURIMI” SHPK  | 4,355,425 lekë | skualifikuar |
| 2. BOE “LORENCO & CO SHPK & GJELBËRIMI 2000 SHPK”                 | 5,201,585 lekë | skualifikuar |
| 3. BOE “ETTA CONS SHPK & ARABEL – STUDIO SHPK & JOKLEN & CO SHPK” | 5,774,650 lekë | kualifikuar  |

II.3.1. Operatori ekonomik “LURIMI” SHPK rezulton i skualifikuar për arsyen se:

*“Oferta e paraqitur nga O.E “LURIMI” shpk me Nius J68403912U Çmimi total i ofertës 4,355,425 (Katërmilioneqindpesëdhjetëepesëmijëekatërqinde njëzetë epesë) lekë pa Tvsh . Çmimi total i ofertës 5,226,510 (Pesëmilionedyqindenjëzetëegjashtëmijëepesëqindedhjetë) lekë me Tvsh .*

*a.Në kriteret e veçanta të kualifikimit,pika 1,gërma b,kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë : Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; Në seksionin 3: Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike,pika 3.2 në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit,autoriteti kontraktor ka parashikuar si më poshtë vijon: Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditë. Nga verifikimi i dokumentacionit të hedhur në sistemin elektronik rezulton se operatori ekonomik LURIMI shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar Policën e Sigurimit të Ofertës me numër serial 0009378 lëshuar më 13.03.2023 në të cilin parashikohet se: Ky sigurim është i vlefshëm për periudhën 13.03.2023 deri në 90 ditë. Në nenin Neni 83 të ligjit Nr.162/2020“Për Prokurimin Publik”,parashikohet shprehimisht se: 1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, ndërkohë që mund të kërkojë paraqitjen e këtij sigurimi edhe në procedurat nën kufirin e lartë monetar, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. 2. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;*

*b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit*

ose entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, autoriteti ose enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit mundësinë e paraqitjes së sigurimit të ofertës: i. në formën e garancisë bankare; ose ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente. 3. Autoriteti ose enti kontraktor konfiskon sigurimin e ofertës në rast të: a) tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave; b) refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit. c) mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimin të ndonjë kushti tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit. 4. Autoriteti ose enti kontraktor nuk e pretendon vlerën e sigurimit të ofertës dhe kthen menjëherë mbrapsht dokumentin e sigurimit të ofertës, nëse: a) ka përfunduar afati kohor i sigurimit të ofertës; b) është lidhur kontrata dhe është paraqitur sigurimi i kontratës, kur një gjë e tillë kërkohet nga dokumentet e tenderit; c) janë anuluar procedurat e tenderit pa shpallur fitues. 5. Autoriteti ose enti kontraktor raporton pranë Agjencisë së Prokurimit Publik rastet e tërheqjes së operatorit ekonomik sipas parashikimeve të këtij neni. 6. Kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk nënshkruan kontratën, autoriteti kontraktor bën konfiskimin e sigurimit të ofertës. Në rastin kur është përdorur si kriter i përcaktimit të ofertës fituese “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim” dhe kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk arrin të nënshkruajë kontratën, autoriteti kontraktor përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave të përzgjedhura që kanë mbetur, vetëm nëse diferenca ndërmjet ofertës së kualifikuar në vendin e parë dhe të dytë është jo më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës të ofertuesit që është tërhequr. Sa më sipër duke qënë se operatori ekonomik LURIMI shpk, nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës sipas kërkesës së autoritetit kontraktor kriteret e veçanta të kualifikimit pika 1, gërma b, ky kriter konsiderohet i papërbushur. Pra afati i vlefshmërisë për sigurimin e ofertës është 90 ditë, ku në DST është kërkuar 150 ditë. Bazuar në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e operatorit ekonomik LURIMI shpk për mos përbushje të kriteve të veçanta kualifikuese. Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, operatori ekonomik LURIMI shpk, s’kualifikohet.”

II.4. Sipas sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.) rezulton se me datë 13.04.2023 është kryer publikimi i njoftimit të fituesit paraprak në sistemin e prokurimit elektronik (SPE).

II.5. Në datën 20.04.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik është protokolluar ankesa me numër 852 prot., datë 20.04.2023 e operatorit ekonomik “Lurimi” SHPK duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit objekt-ankimi si dhe kualifikimin e BOE BOE “ETTA CONS SHPK & ARABEL – STUDIO SHPK & JOKLEN & CO SHPK”.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të

plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 852/2 prot., datë 20.04.2023 lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Lurimi” SHPK nga procedura e prokurimit objekt-ankimi si dhe kriteret të cilat operatori ekonomik ankimues pretendon se nuk përmbushen nga BOE “ETTA CONS SHPK & ARABEL – STUDIO SHPK & JOKLEN & CO SHPK”.

II.7. Nëpërmjet shkresës me nr.2550/1 prot., datë 19.05.2023, protokolluar me tonën nr. 852/4 prot., datë 22.05.2023, autoriteti kontraktor ka depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacionin lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Lurimi” SHPK nga ku rezulton se sipas informacionit të autoritetit kontraktor ankesa e operatorit ekonomik ankimues është protokolluar në autoritet kontraktor me datë 20.04.2023.

II.8. Referuar informacioni të mësipërm rezulton se autoriteti kontraktor ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe me anë të aktit të KSHA nr. 2139/1 datë 26.04.2023 “Procesverbal” ka vendosur refuzimin e saj

II.9. Nga shqyrtimi i materialeve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, pranë Komisionit të Prokurimit Publik në formë shkresore dhe as në sistem elektronik.

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Lurimi” SHPK i cili kundërshton skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit objekt-ankimi si dhe kualifikimin e BOE “ETTA CONS SHPK & ARABEL – STUDIO SHPK & JOKLEN & CO SHPK”, KPP vëren se,

III.2. Në datën 28.02.2023, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-60602-02-27-2023, me objekt: “Hartimi i Planit të Mbarështimit të Pyjeve e Kullotave (PMPK), Bashkia Kolonjë (EKONOMIA PYJORE Qëndër Novosele),viti 2023”, me fond limit 6,158,250.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 13.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kolonjë.

III.3. Në datë 13.03.2023 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.4. Referuar sistemit të prokurimit elektronik, rezulton se në datën 25.03.2023, është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të

prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat pa TVSH si më poshtë:

- |   |                |              |
|---|----------------|--------------|
| 1. “LURIMI” SHPK  | 4,355,425 lekë | skualifikuar |
| 2. BOE “LORENCO & CO SHPK & GJELBËRIMI 2000 SHPK”                 | 5,201,585 lekë | skualifikuar |
| 3. BOE “ETTA CONS SHPK & ARABEL – STUDIO SHPK & JOKLEN & CO SHPK” | 5,774,650      | kualifikuar  |

III.4.1. Operatori ekonomik “LURIMI” SHPK rezulton i skualifikuar për arsyen se:

*“Oferta e paraqitur nga O.E “LURIMI” shpk me Nius J68403912U Çmimi total i ofertës 4,355,425 (Katërmilionetreqindpesëdhjetëepesëmijëekatërqinde njëzetë epesë) lekë pa Tvsh . Çmimi total i ofertës 5,226,510 (Pesëmilionedyqindennjëzetëegjashtëmijëepesëqindedhjetë) lekë me Tvsh .*

*a.Në kriteret e veçanta të kualifikimit,pika 1,gërma b,kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë : Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; Në seksionin 3: Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike,pika 3.2 në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit,autoriteti kontraktor ka parashikuar si më poshtë vijon: Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditë. Nga verifikimi i dokumentacionit të hedhur në sistemin elektronik rezulton se operatori ekonomik LURIMI shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar Policën e Sigurimit të Ofertës me numër serial 0009378 lëshuar më 13.03.2023 në cilin parashikohet se: Ky sigurim është i vlefshëm për periudhën 13.03.2023 deri në 90 ditë. Në nenin Neni 83 të ligjit Nr.162/2020“Për Prokurimin Publik”,parashikohet shprehimisht se: 1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, ndërkohë që mund të kërkojë paraqitjen e këtij sigurimi edhe në procedurat nën kufirin e lartë monetar, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. 2. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;*

*b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, autoriteti ose enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit mundësinë e paraqitjes së sigurimit të ofertës: i. në formën e garancisë bankare; ose ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente. 3. Autoriteti ose enti kontraktor konfiskon sigurimin e ofertës në rast të: a) tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave; b) refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit. c) mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimin të ndonjë kushti tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit. 4.Autoriteti ose enti kontraktor nuk e pretendon vlerën e*

sigurimit të ofertës dhe kthen menjëherë mbrapsht dokumentin e sigurimit e ofertës, nëse: a) ka përfunduar afati kohor i sigurimit të ofertës; b) është lidhur kontrata dhe është paraqitur sigurimi i kontratës, kur një gjë e tillë kërkohet nga dokumentet e tenderit; c) janë anuluar procedurat e tenderit pa shpallur fitues. 5. Autoriteti ose enti kontraktor raporton pranë Agjencisë së Prokurimit Publik rastet e tërheqjes së operatorit ekonomik sipas parashikimeve të këtij neni. 6. Kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk nënshkruan kontratën, autoriteti kontraktor bën konfiskimin e sigurimit të ofertës. Në rastin kur është përdorur si kriter i përcaktimit të ofertës fituese “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim” dhe kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk arrin të nënshkruajë kontratën, autoriteti kontraktor përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave të përzgjedhura që kanë mbetur, vetëm nëse diferenca ndërmjet ofertës së kualifikuar në vendin e parë dhe të dytë është jo më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës të ofertuesit që është tërhequr. Sa më sipër duke qënë se operatori ekonomik LURIMI shpk, nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës sipas kërkesës së autoritetit kontraktor kriteret e veçanta të kualifikimit pika 1, gërma b, ky kriter konsiderohet i papërbushur. Pra afati i vlefshmërisë për sigurimin e ofertës është 90 ditë, ku në DST është kërkuar 150 ditë. Bazuar në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e operatorit ekonomik LURIMI shpk për mos përbushje të kriterëve të veçanta kualifikuese. Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, operatori ekonomik LURIMI shpk, s’kualifikohet.”

III.5. Sipas sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.) rezulton se me datë 13.04.2023 është kryer publikimi i njoftimit të fituesit paraprak në sistemin e prokurimit elektronik (SPE).

III.6. Në datën 20.04.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik është protokolluar ankesa me numër 852 prot., datë 20.04.2023 e operatorit ekonomik “Lurimi” SHPK duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit objekt-ankimi si dhe kualifikimin e BOE BOE “ETTA CONS SHPK & ARABEL – STUDIO SHPK & JOKLEN & CO SHPK”.

III.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 852/2 prot., datë 20.04.2023 lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Lurimi” SHPK nga procedura e prokurimit objekt-ankimi si dhe kriteret të cilat operatori ekonomik ankimues pretendon se nuk përbushen nga BOE “ETTA CONS SHPK & ARABEL – STUDIO SHPK & JOKLEN & CO SHPK”.

III.8. Nëpërmjet shkresës me nr.2550/1 prot., datë 19.05.2023, protokolluar me tonën nr. 852/4 prot., datë 22.05.2023, autoriteti kontraktor ka depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacionin lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Lurimi” SHPK nga ku rezulton se sipas informacionit të autoritetit kontraktor ankesa e operatorit ekonomik ankimues është protokolluar në autoritet kontraktor me datë 20.04.2023.

III.9. Referuar informacioni të mësipërm rezulton se autoriteti kontraktor ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe me anë të aktit të KSHA nr. 2139/1 datë 26.04.2023 “Procesverbal” ka vendosur refuzimin e saj.

III.9.1. Neni 24, pika 1, “Komisioni i prokurimit Publik” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon se: *“Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij”.*

III.9.2. Neni 30, pika 1, “Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon se: *“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera. Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik”.*

III.9.3. Neni 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon se: *“2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.*

*Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.*

*7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.*

*8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”.*

III.9.4. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar është 7 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi



i njoftimi të anulimit. Në rastin konkret referuar sistemit të prokurimit elektronik rezulton, se publikimi i njoftimit të fituesit paraparak është kryer në datën 13.04.2023. KPP vëren, se ankesa e operatorit ekonomik ankimues “Lurimi” SHPK është paraqitur njëherazi në KPP dhe në autoritet kontraktor (referuar informacionit të këtij të fundit të depozituar në KPP përmes me nr.2550/1 prot., datë 19.05.2023, protokolluar me tonën nr. 852/4 prot., datë 22.05.2023) me datë 20.04.2023.

Në nenin 111, pika 1 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “*Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik*”. Referuar dokumentacionit të administruar rezulton se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesën pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik jashtë afatit të parashikuar nga neni 110 pika 2 e ligjit 162/2020, i cili parashikon se “*2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.*” Referuar parashikimeve të sipërcituara, në rastin konkret llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nis ditën e publikimit të njoftimit të fituesit me datë 13.04.2023 dhe përfundon në ditën e 7-të. Në rastin konkret, afati i fundit për paraqitjen e ankesës në autoritetin ose entin kontraktor, si dhe njëkohësisht në Komisionin e Prokurimit Publik, referuar datës së publikimit të njoftimit të fituesit paraparak, ka qenë data 19.04.2023. Ndërkohë ankesa e depozituar me datë 20.04.2023 njëherazi në KPP dhe në autoritet kontraktor (referuar informacionit të këtij të fundit të depozituar në KPP përmes shkresës me nr.2550/1 prot., datë 19.05.2023, protokolluar me tonën nr. 852/4 prot., datë 22.05.2023) konsiderohet e paraqitur jashtë afateve ligjore të ankimit, duke mos u legjitimuar *ratione temporis*. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ligji *stricto sensu* ka parashikuar, se ankesa dorëzohet njëherazi si pranë autoritetit ose entit kontraktor ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe është përgjegjësi e operatorit ekonomik ankimues, që ta dorëzojë këtë të fundit njëherazi në të dyja institucionet, brenda afatit të parashikuar në ligj.

Në nenin 118, pika 2, gërma “a” të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se: “*Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësisht të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji*”.

Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues me datë 20.04.2023 njëherazi në KPP dhe në autoritet kontraktor (referuar informacionit të këtij të fundit të depozituar në KPP përmes me nr.2550/1 prot., datë 19.05.2023, protokolluar me tonën nr. 852/4 prot., datë 22.05.2023) nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, pasi është dorëzuar jashtë afatit në autoritet kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Vlen të theksohet fakti, se përcaktimi i afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i ankimit, afati i shqyrtimit të ofertave, etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri

juridike për palët e interesuara. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve ligjore, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

III.10. Lidhur me vendimin e KSHA së autoritetit kontraktor për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Lurimi” SHPK, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor lidhur me këtë vendimmarrje nuk ka vepruar në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimit etj., përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga LPP, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Në interpretim sistematik (domethënien e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik), Komisioni i Prokurimit gjykon, se ligjvënësi ka ndarë qartësisht dy momentet procedurale, atë të vlerësimit të ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe momentin e dytë të garancisë procedurale të mbrojtjes së interesave të ligjshme të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, atë të ankimit administrativ pranë autoritetit kontraktor (rishikimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave) nga vetë autoriteti kontraktor por nga një trupë e re, e cila nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesave me komisionin e vlerësimit të ofertave, shqyrtimin e ankesave nga K.Sh.A (Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave). Normativa e parashikuar nga nenet 110 dhe 111 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” rregullon të drejtën e personave të interesuar në një procedurë prokurimi për të paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik në kuadrin e rishikimit administrativ të kësaj procedure, e thënë ndryshe, legjitimitimin për të vënë në lëvizje dhe investimin e autoritetit kontraktor për rishikimin e vendimit të KVO-së. Procedura përpara autoritetit kontraktor si edhe para KPP, ka natyrën e procedurave të nxitura, pasi autoriteti kontraktor nuk mund të bëhet vetëiniciator i fillimit të procedurave kryesisht. Si rregull, investimi i K.Sh.A është i bazuar (faktikisht i kufizuar) nga ankimet e sjella pranë saj vetëm nga subjekte të legjitimuara dhe që plotësojnë kushtet formale të ankesës, ku një prej të cilave është dhe respektimi i afateve të ankimit. Pra, komisioni i shqyrtimit të ankesave në asnjë rast nuk duhet të marrë në shqyrtim një ankesë e cila është paraqitur në mungesë të kushteve formale dhe respektimit të afateve të ankimit, duke nxjerrë në këtë mënyrë një akt në kundërshtim me ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik” dhe referuar ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ky akt është absolutisht i pavlefshëm dhe nuk prodhon asnjë pasojë ligjore. Për këtë arsye, Komisioni gjykon, se vendimi i KSHA për shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Lurimi” SHPK (përmes aktit 2139/1 datë 26.04.2023 “Procesverbal”), është në kundërshtim të plotë me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, ndaj do të shpallet absolutisht i pavlefshëm nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Lurimi” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-60602-02-27-2023, me objekt: “*Hartimi i Planit të Mbarështimit të Pyjeve e Kullotave (PMPK), Bashkia Kolonjë (EKONOMIA PYJORE Qëndër Novosele),viti 2023*”, me fond limit 6,158,250.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 13.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kolonjë.
  2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
  3. Autoriteti kontraktor të anulojë aktin e KSHA nr. 2139/1 datë 26.04.2023 “Procesverbal”për trajtimin e ankesës për procedurën e mësipërme të prokurimit.
  4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Lurimi” SHPK.
  5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**